

PSE REVIZIONOHET PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO?!

ERJOLA GJIKA, INSTITUTI I STATISTIKAVE
ekarpuzi@instat.gov.al

ERJOLA ISMALAJ, INSTITUTI I STATISTIKAVE
eismalaj@instat.gov.al

ENI CELO, INSTITUTI I STATISTIKAVE
ecelo@instat.gov.al

MARINELA NUSHI, INSTITUTI I STATISTIKAVE
mnushi@instat.gov.al

1. HYRJE

Vizioni i INSTAT është të prodhojë statistika të besueshme. Qëllimi është transparenca në lidhje me metodat që përdoren në përpilimin e statistikave dhe përdorimi i të gjithë informacionit në dispozicion në një moment të dhënë kohe. Për të prodhuar vlerësimin më të mirë, statisticienët ndodhen gjithmonë përpara kompromisit ndërmjet saktësisë dhe afatit kohor. Afatet e caktuara për publikim diktojnë nevojën e rishikimit të statistikave.

Këto rishikime synojnë përmirësime në cilësi të të dhënave të publikuara më parë. Ato janë të rëndësishme pasi informacioni i vënë në dispozicion pas botimit të parë, paraqet një tablo tjetër të realitetit, i cili duhet marrë në konsideratë. Përdoruesit jo gjithmonë i mirëpresin ndryshimet e vogla statistikore pas një kohe të gjatë nga publikimi. Për këtë arsye, është e nevojshme që rishikimet të mbështeten në atë që njihet si “Politika e revizionit”, e cila siguron një sërë udhëzimesh dhe parimesh, që favorizojnë transparencën e proceseve dhe sigurojnë besim dhe komunikim efektiv me përdoruesit.

Ky artikull analizon efektet e revizionimit të zakonshëm të Produktit të Brendshëm Bruto, ë duke u fokusuar në komponentët sipas Metodës së Shpenzimeve.

2. KONCEPTET NË LLOGARITË KOMBËTARE

Llogaritë Kombëtare në Shqipëri janë ndërtuar mbi një sërë vrojtimesh dhe burimesh administrative, të cilat matin aktivitetin në ekonomi, në mënyra të ndryshme. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) në vendin tonë matet në dy mënyra:

- Sipas metodës së prodhimit
- Sipas metodës së shpenzimeve

2.1 METODA E PRODHIMIT

Treguesit kryesorë të metodës së prodhimit janë prodhimi, konsumi i ndërmjetëm dhe vlera e shtuar. Prodhimi tregon vlerën e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara në ekonomi gjatë një viti, ndërsa konsumi i ndërmjetëm është vlera e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit. Duke zbritur konsumin e ndërmjetëm nga prodhimi, arrijmë në atë që njihet si vlera e shtuar bruto (VSHB).

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB), sipas metodës së prodhimit, është i barabartë me vlerën e shtuar bruto, duke shtuar tatimet e taksat dhe duke i zbritur subvencionet mbi produktet.

2.2 METODA E SHPENZIMEVE

Metoda e shpenzimeve sjell panoramën e anasjelltë, duke e vlerësuar PBB-në sipas përdorimeve finale të brendshme të produkteve e shërbimeve. Sipas kësaj metode, Produkti i Brendshëm Bruto vlerësohet si vlera e shpenzimeve finale nga konsumatorët, institucionet jofitimprurëse dhe qeveria, duke i shtuar formimin e kapitalit bruto dhe eksportet e mallrave e shërbimeve, duke i zbritur importet e mallrave e shërbimeve.

Revizionimet e zakonshme të PBB-së me baza vjetore janë rezultat i përditësimit dhe plotësimit të burimeve ekzistuese të të dhënave, me informacionin më të fundit për një vit të caktuar.

3. AFATET E REVIZIONIMIT

Ashtu si në vendet e zhvilluara, ku vlerësimi i PPB-së revizionohet disa herë, edhe në Shqipëri ky vlerësim bëhet në dy faza:

- Faza e parë përfshin vlerësimet gjysmë-finale të vitit "t" të cilat kryhen në periudhën t+15 muaj
- Faza e dytë përfshin vlerësimet finale të PBB-së të vitit (t). Në këtë fazë rishikohen dhe njëherë të dhënat e vitit (t), kur vjen seti i të dhënave për vitin (t+1). Kjo bëhet me qëllim që të përfshihet

çdo ndryshim i bërë për vitin (t) dhe të sigurohet konsistenca midis dy viteve të njëpasnjëshme. Këto revizionime kanë për qëllim të përshkruajnë me saktësi të lartë ekonominë e vendit. Është e dobishme të mbahet parasysht korniza dhe afatet kohore për publikimin e vlerësimeve të përmirësuara në mënyrë të vazhdueshme.

4. ARSYET E REVIZIONIMIT

Publiku kërkon të dhëna të sakta sa më shpejt të jetë e mundur. Për të plotësuar këtë nevojë, INSTAT publikon vlerësimet gjysmë-finale. Megjithatë këto të dhëna nuk janë të plota, ato sigurojnë një pasqyrë të saktë të përgjithshme të aktivitetit ekonomik. Ato japin drejtimin dhe tendencat e komponentëve të ndryshëm të ekonomisë, duke siguruar informacion të vlefshëm për bizneset dhe politikëbërësit.

Ndryshimet në vlerësimet gjysmë-finale dhe finale të PBB-së vijnë si rezultat:

- I shtimit të numrit të pasqyrave financiare të vitit (t) të integruara në databaza, pas mbylljes së vlerësimeve gjysmë-finale
- I një numri më të lartë të bizneseve që paraqesin pasqyrat financiare të vitit t+1, duke raportuar po ashtu edhe vitin paraardhës
- Nga revizionimi i të dhënave të tregtisë së jashtme, siç janë importet dhe eksportet e mallrave
- Përditësimi i të dhënave nga Bilanci i Pagesave
- Revizionimi i të dhënave nga Drejtorja e Bujqësisë

5. EFEKTI I REVIZIONIMIT NË PBB

Në vijim të këtij artikulli, tregohet efekti që sjell revizionimi në PBB, duke e parë në aspektin e treguesve kryesorë, sipas metodës së shpenzimeve. Për këtë qëllim, janë analizuar vlerat përkatëse në vlerësimin gjysmë-final të vitit 2015, kundrejt atij final.

Si rezultat i rivlerësimit, PPB me çmime korrente, ndryshoi nga 1.427.799 milionë lekë në vlerësimin gjysmë-final, në 1.434.307 milionë lekë në atë final. Pas revizionimit të rezultateve, norma e rritjes reale u ul me 0,01 pikë përqindje.

Kontributi i komponentëve përkatës në rritjen reale të PBB-së, ka ndryshuar nga vlerësimi gjysmë-final në atë final të vitit 2015. Në vlerësimin gjysmë-final, shpenzimet e konsumit final të familjeve (SHKFF) kanë kontribuar në rritjen e PBB-së me 0,80% dhe formimi bruto i kapitalit fiks (FBKF) me 0,97%. Ndërkohë, në vlerësimin final, SHKFF ka kontribuar me 0,73% dhe FBKF me 0,85%.


Shpenzimet e konsumit final të familjeve (HFCE – Household Final Consumption Expenditure) përfshijnë shpenzimet e kryera nga familjet për mallra dhe shërbime, për të plotësuar kërkesat individuale, përfshirë edhe ato me çmime ekonomikisht jo të rëndësishme. Ato përfshijnë gjithashtu shpenzime të imputuara, ku më i rëndësishmi është renta e imputuar. Shpenzimet e konsumit final të familjeve përbëjnë 79,9% të produktit të brendshëm bruto në vitin 2015 (sipas vlerësimit final). Për sa i përket rritjes, në vlerësimin gjysmë-final të vitit 2015, vlerën më të lartë në SHKFF e ka grupi “Hotele, kafene dhe restorante” me 12,09% në terma realë. Në vlerësimin final, ky grup vazhdon të ketë rritjen më të madhe, por me 13,02% në terma realë.

Nga ana tjetër, rënien më të madhe, sipas vlerësimit gjysmë-final, e gjejmë në grupin e “Argëtimit dhe kulturës” me 12,39% në terma realë. Në vlerësimin final, është sërish ky grup me rënien më të madhe, por në nivele më të ulëta, me 11,53% në terma realë.

Në vazhdim, do të analizohet efekti i revizionimit në Formimin Bruto të Kapitalit Fiks (GFCF-Gross Fixed Capital Formation), i cili konsiston në shpenzimet e kryera për kapitale të reja, ose për shpenzime të tjera specifike, të kryera nga prodhuesit në të mira ose shërbime, me qëllim që të mbajnë në të njëjtat nivele, të rritin ose të zgjerojnë kapacitetet e tyre prodhuese, ose që të krijojnë kushte të reja përpunimi në të ardhmen. Si një ndër komponentët kryesorë të PBB-së në metodën e shpenzimeve, formimi bruto i kapitalit fiks ka një peshë prej 24,4% në PBB (sipas vlerësimit final të vitit 2015). Kështu, rritjen më të lartë në FBKF, në vlerësimin gjysmë-final të vitit 2015, e ka grupi “Makineri dhe Pajisje” me 15,85% në terma realë. Gjithashtu, në vlerësimin final të këtij viti, rritjen më të lartë në FBKF e ka po ky grup, por në nivele më të ulëta, me 15,81% në terma realë. Grupi “Ndërtimi”, po ashtu, është rritur më pak sipas vlerësimit final, krahasuar me atë gjysmë-final, duke kaluar nga 6,03% në 5,68% rritje, në terma realë.

Figura 1 paraqet rezultatet e rritjes reale si rrjedhojë e revizionimit.

Figura 1: Rritja reale pas revizionimit



6. REZULTATET E REVIZIONIMIT TË ZAKONSHËM

Vihen re ndryshime midis vlerësimeve finale dhe atyre gjysmë-finale, të cilat janë relativisht të vogla:

- Rritja reale e PBB-së pas revizionimit u ul me 0,01 pikë përqindje.
- Kontributi i SHKFF në rritjen reale të PBB-së u ul me 0,07 pikë përqindje.
- Pas revizionimit të rezultateve, norma e rritjes së grupit “Hotele, kafene dhe restorante” u rrit me 0,93 pikë përqindje.
- Norma e rënies së grupit të “Argëtimit dhe Kulturës” është zbutur, duke u rritur me 0,86 pikë përqindje si pasojë e revizionimit të zakonshëm.
- Kontributi i FBKF në rritjen reale të PBB-së u ul me 0,12 pikë përqindje
- Ndryshimi më i madh nga revizionimi, në FBKF, është ndier tek grupi “Ndërtimi” me 0,35 pikë përqindje rënie në terma realë, duke u ndjekur nga grupi “Makineri dhe Pajisjet” po ashtu në rënie me 0,04 pikë përqindje në terma realë.

Megjithëse bëhen rishikime të vlerësimeve të PBB-së, pasi sigurohen të dhëna më të plota, studimet tregojnë se pamja e përgjithshme e ekonomisë nuk ndryshon.

Matja e PBB-së është një punë gjithmonë në progres. Shpesh kërkon muaj, ose madje vite, për të siguruar të dhëna më të plota dhe më të sakta. Vlerësimet gjysmë-finale ruajnë një ekuilibër të mirë midis saktësisë dhe kohës, duke pasur parasysh të dhënat e disponueshme në atë kohë. Rishikimet e njëpasnjëshme pasqyrojnë angazhimin e INSTAT për të përfshirë si burime më të plota, kur ato bëhen të disponueshme, ashtu edhe përmirësimin e metodave për matjen e një ekonomie në ndryshim të vazhdueshëm.

7. PRAKTIKA TË VENDEVE TË TJERA

Edhe në vendet e tjera, objektivi kryesor i rishikimit të të dhënave statistikore synon përmirësimin e cilësisë së informacionit të ofruar. Ka arsye të ndryshme për kryerjen e rishikimeve të zakonshme të statistikave, ku më kryesorja është futja në llogaritje e të dhënave të reja që lidhen me të shkuarën, të cilat nuk mund të përfshiheshin në kohën kur u përpiluan dhe u publikuan në versionin e parë.

Rasti i Gjermanisë

Për të publikuar sa më shpejt të dhënat më të fundit për "rritjen ekonomike", rezultatet llogariten në bazë të të dhënave jo të plota dhe të vlerësuara pjesërisht. Këto rezultate paraprake të prodhimit të brendshëm bruto do të përditësohen vazhdimisht në publikime të ardhshme, kur të dhënat e reja statistikore bëhen të disponueshme. Korrigjimet e rezultateve paraprake, me kalimin e kohës ndjekin një cikël revizionimi të njohur dhe të botuar. Përfshirja e këtij informacioni të ri është veçanërisht i nevojshëm nëse ka thyerje në seri

kohore. Kjo është e domosdoshme për krahasimin e të dhënave me vitin e kaluar. Një herë në vit bëhet një vlerësim kryesor i llogarive kombëtare me një rishikim gjithëpërfshirës të viteve të mëparshme, i cili përfshin katër vitet e fundit. Këto rezultate publikohen gjithmonë në muajin gusht. Në veçanti, në këtë revizionim, merren parasysh të dhëna nga skedarë të tatim-taksave dhe anketës strukturore pranë ndërmarrjeve. Vrojtimi strukturor i ndërmarrjeve është i bazuar, në veçanti, në pasqyrat financiare vjetore të ndërmarrjeve dhe mbi të gjitha japin informacion mbi kostot e tyre. Në të kundërt, llogaritjet paraprake bazohen vetëm në treguesit aktualë të prodhimit. Një nga sfidat kryesore, për të arritur vlerësime sa më të sakta paraprake të rritjes ekonomike, janë momentet e ndryshimeve në ekonomi. Revizionimet e PBB-së kanë ndikime më të mëdha në këto raste, meqenëse rezultatet paraprake të shumë statistikave fillestare nuk arrijnë t' i kapin këto momente ndryshimi. Përveç kësaj, ekzistojnë efekte të veçanta si, për shembull, rritja e TVSH-së ose kushte ekstreme moti, ndikimi i të cilave është i vështirë të vlerësohet. Në këtë kuadër, duket qartë që korrektimet mund të jenë më të shpeshta dhe më të mëdha në një ekonomi dinamike.

BIBLIOGRAFI

"Revisions and the Income and Expenditure Accounts", Catalogue no. 13-604-M — no. 068, Statistics Canada

"Volkswirtschaftliche Gesamtrechnungen", Revisionsbedarf des Bruttoinlandsprodukts, Statistisches Bundesamt

Ahmad, Nadim, Sophie Bournot and Francette Koechlin. 2004. "Revisions to quarterly GDP estimates: A comparative analysis for seven large OECD country" OECD

Fixler, Dennis J. and Bruce T. Grimm. 2003. "Revisions, Rationality, and Turning Points in GDP". U.S. Bureau of Economic Analysis.

Graeme Walker, Andrew Walton and Tiffany Georghiades, "Why is GDP revised?", Office for National Statistics, UK

<http://www.instat.gov.al/al/temat/ekonomi-dhe-financë/llogaritë-kombëtare-gdp/publikimet/2018/produkti-i-brendshëm-bruto-finale-2015-dhe-gjysmë-finale-2016/>

McKenzie Richard, Elena Tosetto (OECD) and Dennis Fixler (United States Bureau of Economic Analysis) 2008. "Assessing the efficiency of early release estimates of economic statistics". OECD.

Peter van de Ven and George van Leeuwen, "Discussion", Vol. 20, No. 4, 2004, pp. 607–614, Journal of Official Statistics

Smith, Philip. 1977. "An Analysis of the Revisions to the Canadian National Accounts" Statistics Canada Working Paper STC4370E.